

STATUT
I
SHOQERISE TREGTARE NORD GAZ AL SH.A

Ne baze te ligjit nr 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" dhe ne zbatim me ligjin nr.131/2015 "Per Qendren Kombetare te Biznesit",ligjit nr 129/2014 "Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin 9901 date 14/04/2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare " te ndryshuar krijohet Shoqeria tregtare NORD GAZ AL SH.A e cila ne ushtrimin e aktivitetit te saj do te bazohet ne legjislacionin shqiptar persa me lart.

KREU I

Dispozita te pergjithshme

NENI 1

Shoqeria NORD GAZ AL SH.A eshte person juridik shqiptar.

Ajo gezon personalitet juridik e regjistruar ne Regjistrin Tregtar dhe ne Organin tatimor.

Shoqeria zhvillon veprimtarine e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe dispozitat e parashikuara ne kete statut.

NENI 2

Shoqeria NORD GAZ ALSH.A eshte nje shoqeri aksionere ne seli ne Lezhe, Spiten, zona kadastrale nr 3502, pasuria me nr: 24/24.

Ajo mund te hape perfaqesi,dege ose filiale edhe ne qytete te tjera te Shqiperise.

NENI 3

Afati i veprimtarise do te jete i pakufizuar.

NENI 4

Emertimi i shoqerise eshte NORD GAZ ALSH.A

Ky emertim vendoset ne te gjitha letrat qe perdoren per korespondence ne faturat,ne te gjitha reklamat dhe botimet e nxjerra prej saj dhe do te pasohet nga fjala "SH.A" ose "Shoqeri anonime" nga numri i regjistrimit te saj dhe selia.

KREU II

Objekti i veprimtarise

NENI 5

Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jete:


Transportimin , depozitimin e naftes brut, gazit dhe nenprodukteve te tyre, gazeve teknologjike industriale, si dhe biokarbureve.Projektimi, ndertimi dhe perdorimi i impianteve teknologjike industriale per rikondicionimin dhe



kolaudimin e
bombolave, cisternave te permasave te ndryshme
te cilat perdoren
per gazin natyror, gazin e lengezuar te naftes,
gazet teknologjike
industriale, si dhe produkt ne gjendje te gazte, qe
amballazhohet,
transportohet dhe tregohet me bombola, cisterna
dhe autocisterna.
Konsulence dhe asistence ne fushen e
projektimit, ndertimit dhe
perdorimit te impianteve, depozitave,
tubacioneve, aparaturave
aksesoreve dhe teknologjive qe sherbejne per
prodhimin ,
transportimin depozitimin dhe tregtimin e naftes
brut gazit dhe
nenprodukteve te tyre, gazeve teknologjike
industriale , si dhe
biokarbureve. Import eksport dhe tregtimi me
shumice e pakice i
mallrave te ndryshme industriale materiale
ndertimi, pajisje e
aparatura qe sherbejne per projektimin
ndertimin dhe perdorimin
e Impianteve teknologjike, industriale, rafinerive
per perpunimi e
naftes brut , gazit dhe neprodukteve te tyre ,
gazeve teknologjike si
dhe biokarbureve, Tubacioneve , depozitave dhe
impianteve per
transportimin , depozitimin e naftes brut gazit
dhe nenprodukteve
te tyre, gazeve teknologjike si dhe biokarbureve,
Impianteve
teknologjike industriale per rikondicionimin e
kolaudimin e
bombolave cisternave. Transport rrugor
nderkombetar mallrash per
te trete e me qera.

NENI 6

Themeluesi i shoqerise rezervon te drejten te modifikojte objektin e veprimtarise ne cdo kohe.



KREU III

Kapital i regjistruar

NENI 7

Kapitali i regjistruari shoqerise eshte 4.000.000 leke shqiptare i ndare ne 100 aksione te barabarta me vlere nominale nga 40.000 leke secila.

Aksionet jane te numertuar nga 1 deri ne 100 aksione.

Sot ne daten e krijimit te Shoqerise jane shlyer aksione ne vleren nominale te tyre te cilat i korrespondojne 1/ 4 te kapitalit te regjistruar te Shoqerise perkatesisht 1.000.000 (teteqind e shtatedhjete e pesemije)leke cka konfirmohet nga mandate bankar per ngurtesimin e fondeve per efekt te themelimit e te regjistrimit te kesaj Shoqerie ne Qendren Kombetare te Biznesit.

Aksioneri i vetem eshte Z.Altin Xhari, I dtl 21/01/1973, lindur ne Brezhda, banues ne Lezhe, shtetas shqiptar i pajisur me leternjoftimin me nr: 034288546, numer personal H30121063A, madhore me zotesi te plote per te vepruar , i cili zoteron 100 aksione me vlere nominale 35.000 leke secili ose 100% te aksioneve te Shoqerise.

Ne perputhje me dispozitat e ligjit dhe pa cenuar te drejtat qe rrjedhin nga aksionet ekzistuese,aksionet e reja mund te emetohen me te drejta ose kufizime te parashikuara ne vendimin e Asamblese se Pergjithshme te marre me shumice te kaulifikuar ose aksionari i vetem ne kete rast.

Asambleja e Pergjithshme me te njejten shumice te kualifikuar votash mund te vendose emetimin e obligacioneve te cilat u garantojne zoteruesve te tyre te drejten per ti kthyer ne aksione(obligacionet e kthyeshme) dhe obligacionet qe bejne te mundur pjesmarrjen e zoteruesve te tyre ne ndarjen e fitimeve ne dobi te aksionareve.

NENI 8

Certifikatat e aksioneve

Aksioneri ka te drejte te perfitoj nje certificate per te gjitha aksionet e zoteruara nga ai pasi te jete kryer pagesa e nje shume qe do te percaktohet nga Asambleja e Pergjithshme ose Aksionari i vetem ne kete rast.

NENI 9

Regjistri i aksioneve

Administratori ne perputhje me dispozitat e ligjit dhe te ketij statuti eshte pergjegjes per krijimin e funksionimin e regjistrit te aksioneve te shoqerise ne perputhje me nenin 119 te ligjit.

NENI 10

Kalimi me kontrate i aksioneve

Kontrata e kalimit te aksioneve behet me shkrim dhe sipas formaliteteve te percaktuara nga Administratori pergjegjes per mbajtjen e regjistrit te aksioneve te Shoqerise dhe do te zbatohet nga dhe per llogari te personit qe kalon aksionet ose nga personi i autorizuar prej tij dhe nga e per llogari te personit te cilit i kalohen aksionet ose nga personi i autorizuar prej tij nepermjet regjistrimit ne regjistrin e aksioneve te shoqerise ne perputhje me nenin 119 te ligjit.

NENI 11

Kalimi i aksioneve me trashegimi ose Falimentim



Nese aksioneri vdes, trashegimtari ose trashegimtaret ne rastin e bashkezoterimit te aksioneve dhe perfaqesuesit e tij ne rast se ky person ishte zoterues ose trashegimtar i vetem do te jene personat e vetem te njohur nga Shoqeria si gezues i te drejtave mbi aksionin e tij; pavaresisht parashikimeve te ketij statuti, pasuria e aksionarit te vdekur nuk clirohet nga pergjegjesia ne lidhje me cdo aksion te bashkezoteruar me persona te tjere.

Personi qe fiton te drejten mbi nje aksion si pasoje e vdekjes ose falimentimit te nje aksionari pas paraqitjes se provave te kerkuara nga Administratori mund te zgjedhe te behet zoterues i aksionit ose te kerkoje regjistrimin e aksionit ne emer te nje personi tjetër te caktuar prej tij si perfitues i aksionit. Nese personi i mesiperem zgjedh te behet zoterues i aksionit ai njofton shoqerine ne lidhje me kete zgjedhje. Nese ky person zgjedh qe nje person tjetër te regjistrohet si zoterues i aksionit ai e kalon aksionin te dobi te personit tjetër.

Personi qe fiton te drejta mbi nje aksion si pasoje e vdekjes ose falimentimit te nje aksionari gezon te drejtat qe gezonte zoteruesi i aksionit duke perjashtuar te drejten e pjesmarrjes ose te votes ne cdo mbledhje te Asamblese se Pergjithshme te Shoqerise ose mbledhjeve te posacme te aksionareve te cdo klase aksionesh, deri ne momentin e regjistrimit ne regjistrin e aksioneve te Shoqerise si zoterues te aksionit.

NENI 12

Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit themetar

Kur emetohen aksione te reja keto aksione iu ofrohen aksionareve ekzistues perpara se t'u ofrohen aksionareve te tjere te rinj ne pajtim me nenin 174 te Ligjit. Aksionet e reja iu ofrohen aksionareve sipas numrit te aksioneve qe zoterojne perpara ofertes. Oferta qe iu behet aksionareve ekzistues duhet te pranohet brenda 20 ditesh.

Aksionet te cilat deri ne momentin e miratimit te vendimit te permendur ne piken 1 te ketij neni nuk jane pranuar ose nuk eshte rene dakort te pranohen nga asnje aksionar mund te anulohen dhe kapitali themeltar te zvogelohet ne perputhje me vleren e aksioneve te anuluar.

Ne pajtim me ligjin, Asambleja e Pergjithshme mund te vendose zvogelimin e kapitalit themeltar te Shoqerise me shumicen e kualifikuar te votave, te percaktuara ne fjaline e dyte, pika 1 te ketij neni.

KREU III

Asambleja e Pergjithshme /Aksionari i vetem


NENI 13

Thirrja e Asamblese se Pergjithshme/aksionar i vetem

Asambleja e Pergjithshme thirret nga Administratori te pakten dy here ne vit. Keshilli i mbikqyrjes mund te therase Asamblene e Pergjithshme ne rastet e parashikuara ne nenin 136 te ketij ligji.

Mbledhja e Asamblese se Pergjithshme thirret nepermjet nje njoftimi te derguar me poste ose poste elektronike drejtuar cdo aksionari perfshire edhe perfaqesuesin e aksioneve ne zoterim te perbashket. Njoftimi duhet te kryhet te pakten njezet e nje dite te plota perpara dates se caktuar per mbledhjen.

Mbledhja e Asamblese se Pergjithshme jane te pavlefshme ne rast moskryerje te paqellimshme te njoftimit apo mosmarrjes se njoftimit te mbledhjes nga personat te cilet kane te drejte te marrin



kete njoftim me perjashtim te rastit kur Shoqeria provon se personi i ka dhene shoqerise nje adrese te pasakte.

NENI 14

Mbledhja e Asamblese se Pergjithshme

Asambleja e Pergjithshme merr vendime te vlefshme vetem me arritjen e kuorunit te parashikuar nga neni 144 I ligjit. Aksionaret ose perfaqesuesit e autorizuar mund te marrin pjese nepermjet mjeteve elektronike ne perputhje me nenin 142 te ligjit.

Keshilli mbikqyres cakton nje administrator si Kryetar te mbledhjes si dhe nje person per te mbajtur procesverbalin e mbledhjes.

Nese asnje nga Administratoret nuk deshiron te caktohet si Kryetar i mbledhjes ose nese asnje prej Administratoreve nuk eshte pranishem per pesembledhete minuta duke filluar nga ora e caktuar per fillimin e mbledhjes ,aksionaret e pranishem dhe me te drejte vote zgjedhin njerin prej tyre si kryetar te mbledhjes.

Administratori ose anetari i Keshillit mbikqyres pavaresisht se nuk eshte aksionar ka te drejten e pjesemarrjes si dhe te marre fjalen ne cdo mbledhje te asamblese se pergjithshme dhe ne mbledhjet e vecanta te aksionareve zoterues te aksioneve te klasave te ndryshme.

Kryetari me pelqimin e Asamblese se Pergjithshme te mbledhur ne pajtim me kuorumin e caktuar nga ligji mund (dhe eshte i detyruar nese kerkohet nga Asambleja e Pergjithshme)te shtyje mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme por e mbledhjen e dyte mund te diskutohenvetem ato ceshtje te cilat do te ishin diskutuar rregullisht nese nuk do te ishte shtyre mbledhja e meparshme.

Kur mbledhja e Asamblese se Pergjithshme shtyhet te pakten katermbledhete dite , njoftimi do te kryhet te pakten shtate dite te plota perpara kesaj date dhe net e do te percaktohet ora dhe vendi i mbledhjes se shtyre dhe pershkrimi i pergjithshem i rendit te dites.Ne rasy te kundert dhenia e njoftimitnuk eshte e nevojshme.

Asambleja vendos me votim te hapur me perjashtim te rastit kur perpara ose gjate deklarimit te rezultatit,nuk kerkohet ne menyren e duhur nje votom i fshehte.Votimi i fshehte mund te kerkoher nga:

1-Kryetari ose

2-Aksionari qe perfaqeson te pakten 5 % te kapitalit themeltar te Shoqerise.

Kerkesa e bere nga nje perfaqesues i autorizuar i aksionarit ka te njejten vlere me kerkesn e paraqitur nga vete aksionari.

Me perjashtim te kundershtimit te nje aksionari deklarimi i kryetarit se vendimi eshte marre ne menyre unanime, ose me nje shumice te caktuar , ose nuk eshte miratuar nga nje shumice te caktuar dhe regjistri perkates ne rocesverbalin e mbledhjes perben prove perfundimtare te ketij fakti pa pasur nevoje per numerimin e votive te regjistruara pro ose kunder vendimit.

Ne rast se ka kundershtime per kete deklarate do te zhvillohet nje votim i fshehte ne lidhje me percaktimin numrit te votave pro dhe kunder vendimit.

NENI 15

Votat e pjesmarresve



Ne perputhje me te drejtat ose kufizimet qe rjedhin nga aksionet, cdo aksioni i jep aksionarit te pranishem apo perfaqesuesit te tij te autorizuar ose aksionarit (ne rastin kur eshte person juridik) i cili eshte i pranishem nepermjet perfaqesuesit ligjor apo perfaqesuesit te autorizuar ne menyre te rregullt, te drejten e nje vote.

Asnje aksionar nuk voton ne mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme apo ne mbledhjet e vecanta te zoteruesve te aksioneve te klasave te ndryshme personalisht apo nepermjet perfaqesuesve ne lidhje me aksionet e zoteruara prej tij, nese nuk ka shlyer teresisht detyrimet qe kane te bejne me keto aksione.

Cdo kundershtrim ne kohe per cilesine e nje votuesi do ti komunikohet kryetarit, vendim i cili do te jete perfundimtar. Te gjitha votat e pakundershtuara ne nje mbledhje do te jene te vlefshme.

NENI 16

Votimi me prokure

Perfaqesuesi do te emerohet nga nje pjesmarres ne mbledhje sipas formes se miratuar nga administratori.

NENI 17

Emerimi i eksperteve kontabel te autorizuar

Me propozim te Keshillit Mbikqyres Asambleja e Pergjithshme cakton eksperte kontabel te autorizuar Z. Iris Qirjaqi, e dtl 17/08/1988, lindur ne Shkoder e banuese ne Tirane, e pajisur me leternjoftimin me nr: 036850057, numer personal I85817089K, e regjistruar me nr NIPT L56512005F, e pajisur me Licensen nr: 350 date 16.01.2015, me seli te ushtrimit te aktivitetit ne Tirane.

Gjate mandatit te saj I cili eshte I percaktuar per 1 vit ushtrimor, eksperti kontabel i autorizuar mund te largohen nga detyra vetem per shkaqe te arsyeshme.

Eksperti kontabel i autorizuar i raporton Keshillit Mbikqyres per ceshtjet kryesore qe rezultojne nga kontrolli financiar dhe ne vecanti per dobesi te kontrollit te brendshem ne lidhje me procesin e raportimit financiar.

KREU IV

Neni 18

Emerimi i administratoreve


Emerimi i administratorit eshte kompetence ekskluzive e Aksionarit te vetem.

Administrator i shoqerise eshte **Z. Altin Xhari**, I dtl 21/01/1973, lindur ne Brezhda, banues ne Lezhe, shtetas shqiptar i pajisur me leternjoftimin me nr: 034288546, numer personal H30121063A, me kohezgjatje te mandatit per 3 vjet.

Neni 19

Kompetencat e Administratorit

Politikat tregtare te Shoqerise do te administrohen dhe Shoqeria do te perfaqesohet nga Administratori i cili mund te ushtroje te gjitha kompetencat ne perputhje me parashikimet e pikes



2 neni 167,shkronja a,g,h dhe i dhe pikes 1 e nenit 154dhe pikave 3 dhe 5 te nenit 158 te Ligjit. Detyrat e Keshillit Mbikqyres ne perputhje me parashikimet e pikes 1 ne nenit 167dhe shkronjave b,c,c,d,dh,e,e,f,g,i, te pikes 154 te Ligjit nuk mund t'iu delegohen Administratoreve. Ndryshimet e statutit nga Asambleja e Pergjithshme dhe te udhezimeve te Keshillit Mbikqyres nuk do te shfuqizojne akte te meparshme te Administratoreve te cilat do te ishin te vlefshme nese ndryshimi nuk do te ishte kryer ose udhezimi nuk do te ishte dhene.

Neni 20

Skualifikimi dhe shkarkimi i administratorit

Detyra e administratorit perfundon ne rast se

1-Personi nuk eshte me administrator ne baze te dispozitave te ligjit perfshire shkarkimin nga Keshilli Mbikqyres ne pajtim me piken 2 ne nenit 167 dhe shkronjen c te pikes 2 te nenit 135 te Ligjit.

2-Personi ndodhet ne gjendje te paaftesise pagueuse

3-Personi vuan ose mund te vuaj nga crregullime mendore

4-Personi jep doreheqjen nga detyra duke njoftuar shoqerine.

KREU V

Keshilli Mbikqyres

Neni 21

Emerimi i anetareve te Keshillit Mbikqyres

Asambleja e Pergjithshme emerion te pakten 3 ose me shume persona fizik, gjithmone me nje numer jo me te madh se 21 ne cilesine e anetareve te Keshillit Mbikqyres ne perputhje me shkronjen c te pikes 2 te nenit 135, pikes 4 te nenit 167 dhe pikes 2 te nenit 155 te Ligjit. Emerimet do te jene individuale dhe ne perputhje me vendimin e mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme te marre me shumice votash i cili nese miratohet sjell emerimin e personit te propozuar si anetare te Keshillit Mbikqyres.

Antaret e keshillit mbikqyres mund te shkarkohen nga detyra ne cdo kohe nga Asambleja e Pergjithshme pa cenuar te drejtat qe burojne nga nje kontrate pune e lidhur me Shoqerine.

Nuk mund te zgjidhen ne cilesine e anetarit te Keshillit Mbikqyres administratoret e shoqerise dhe Shoqerive te te njejtit grup apo personat e lidhur me ta ne perputhje me parashikimet e pikes 3 ne nenit 13 te Ligjit. Kufizimet per emerimet e anetareve te Keshillit Mbikqyres parashikohen nga neni 156 te Ligjit.


Shumica e anetareve te Keshillit Mbikqyres duhet te jene te pavarur sipas parashikimeve te pikave 1 dhe 4 te nenit 155 te ligjit.

Keshilli Mbikqyres mund te emeruje nje person i cili deshiron te ushtroje detyren e antarit te Keshillit Mbikqyres per te plotesuar nje vend te lire ose si nje anetar tjetër shtese, me kusht qe te mos tejkalohet numri i anetareve te percaktuar ne piken 1 te ketij neni. Kohezgjatja ne detyre e antarit te emeruar ne kete menyre eshte deri ne mbledhjen vjetore vijuese te Asamblese se Pergjithshme.

Anetaret e Keshillit Mbikqyres te Shoqerise **NORD GAZAL S.H.A** jane:

Anetare te Keshillit Mbikqyres caktohen:

1-Alma Xhari, e dtl 02/01/1977, lindur ne Rreshen, banuese ne Lezhe, shtetase shqiptare e pajisur me leternjoftimin me nr: 034288541, numer personal H75102062D.



2-Amadeos Xhari, I dtl 27/11/1998, lindur ne Lezhe, banues ne Lezhesh tetas shqiptar I pajisur me leternjoftimin me nr: 032814147, numer personal J81127059L.

3-Anseda Xhari, e dtl 03/10/2003, lindur ne Lezhe e banuese ne Lezhe, e pajisur me pashaporten biometrike me nr:BR0384094, numer personal K36003058B, **me kohezgjatje te mandatit te tyre 3 vjet.**

Kryetare e Keshillit Mbikqyres emerohet Zj. Alma XHARI me identitet si me lart me kohezgjatje te mandatit 3 vjet.

Neni 22

Kompetencat e Keshillit Mbikqyres dhe Komiteteve te tij

Keshilli Mbikqyres nuk merr pjese ne administrimin e Shoqerise. Keshilli Mbikqyres vezhgon dhe mikqyr zbatimin e politikave tregtare nga administratoret dhe kontrollon pajtueshmerine me kerkesat e ligjit dhe Statutit. Detyrat e Keshillit Mbikqyres te percaktuara nga pikat 1 e nenit 167, shkronjat b,c,c,d,dh,e,e,f,g,e te pikes 1 dhe 2 e nenit 154 te Ligjit nuk mund t'i udelegohen Administratoreve.

Keshilli Mbikqyres mund t'ia delegoje kompetencat e veta nje komiteti qe perbehet nga nje ose me shume anetare te Keshillit Mbikqyres. Ky delegim mund te behet ne perputhje me kushtet qe mund te vendosen nga Keshilli Mbikqyres e mund te revokohet ose ndryshohet. Keshilli Mbikqyres nuk mund te delegoje asnje nga detyrat te cilat i ngarkohen ne pajtim me dispozitat ligjore.

Ne perputhje me sa me siper Keshilli Mbikqyres krijon :

- 1- Nje komitet i cili percakton standartet per emerimin e Administratoreve nga Asambleja e Pergjithshme
- 2- Nje komitet i cili percakton skemen e shperblimit dhe shperblimin individual te Administratoreve dhe anetareve te Keshillit Mbikqyres.
- 3- Nje komitet per kontrollin e mbarevajtjes dhe kontabilitetit te Shoqerise.
- 4- Komitetet e emerimit ,shperblimit dhe kontrollit japin rekomandime te cilat synojne pergatitjen e vendimeve qe duhen marre nga Keshilli Mbikqyres. Qellimi kryesor i komiteteve eshte rritja e efikasitetit te keshillit Mbikqyres duke u kujdesur qe vendimet te merren ne menyren e duhur si dhe te ndihmoje organizimin e punes me synim sigurimin e vendimmarrjes qe nuk perben konflikt te interesave materiale.Krijimi i Komiteteve nuk zhvendos ceshtjet e marra ne shqyrtim nga Keshilli Mbikqyres i cili mbetet organi pergjegjes per vendimet e marra ne fushen e tij te kompetences.
- 5- Ne vecanti Komiteti i kontrollit financiar
 - a-mbikqyr procesin e raportimit financiar
 - b-mbikqyr efektivitetin e sistemit te kontrollit te brendshem dhe sistemit te administrimit te rreziqeve.
 - c-mbikqyr kontrollin e bilanceve vjetore dhe te konsoliduara sipas Statutit
 - d-shqyrton dhe mbikqyr pavaresine e eksperteve kontabel te autorizuar ose te Shoqerise se eksperteve kontabel te autorizuar dhe ne vecanti ofrimin e sherbimeve te tjera shtese per subjektin e kontrolluar.
- 6-Bazuar ne vendimet e komisioneve te tij Keshilli Mbikqyres

a-i paraqet propozime Asamblese se Pergjithshme ne lidhje me emerimin e Administratoreve dhe eksperteve kontabel te autorizuar.

b-harton raportin mbi ecurine e veprimtarise sipas pikes 1 te nenit 154 te ligjit dhe ja dorezon ate Asamblese se Pergjithshme sipas pikes 3 te nenit 137 te Ligjit.

c- harton raportin vjetor per drejtimin e brendshme te shoqerise dhe kualifikimin e Administratoreve dhe anetareve te Keshillit Mbikqyres dhe e ben publik ate sipas parashikimeve te pikes 2 te nenit 134 te Ligjit.

7-Asnje ndryshim i statutit dhe udhezim i Asamblese se Pergjithshme nuk mund te beje te pavlefshme veprimet e meparshme te Keshillit Mbikqyres te cilat do te kishin qene te vlefshme nese nuk do te ishte bere ndryshimi ose nese nuk do te ishte dhene udhezimi.

Neni 23

Skualifikimi dhe largimi i anetareve te Keshillit Mbikqyres

Detyra e anetarit te Keshillit Mbikqyres perfundon ne rast se :

- 1- Personi pushon se qeni anetar i Keshillit Mbikqyres ne baze te dispozitave te Ligjit duke perfshire parashikimet e pikes 4 te nenit 167 dhe nenit 175.
- 2- Personi ndodhet ne gjendje te paaftesise pguese
- 3- Personi vuan ose mund te vuaje nga crregullime mendore
- 4- Personi jep doreheqjen nga detyra duke njoftuar shoqerine ,ose
- 5- Ka munguar me shume se gjashte muaj rredhazi pa lejen e anetareve te tjere te Keshillit Mbikqyres ne mbledhjet e ketij Keshilli te mbajtura gjate kesaj periudhe nga Asambleja e Pergjithshme me propozim te Keshillit Mbikqyres vendos ta shkarkoje nga detyra.

Neni 24

Mbledhjet e Keshillit Mbikqyres


Mbledhjet e Keshillit Mbikqyres do te mbahen te pakten dy here ne vit sipas nevojave te aktivitetit tregtar te Shoqerise.

Vendimet e Keshillit Mbikqyres merren me kuorumin e percaktuar ne piken 5 te nenit 167 dhe nenit 162 te Ligjit. Anetaret e keshillit Mbikqyres mund te marrin pjese ne mbledhje nepermjet mjeteve elektronike te komunikimit perfshire komunikimin video dhe audio conference.

Anetaret e Keshillit Mbikqyres emerojne njerin prej tyre si kryetare te Mbledhjes i cili mund te shkarkohet ne cdo kohe nga kjo detyre. Kryetari do te drejtoje cdo takim te Keshillit Mbikqyres ne te cilin ai eshte i pranishem. Ne rast se kryetari nuk deshiron te drejtoje mbledhjen apo nuk eshte i pranishem brenda 5 minutave nga orari i caktuar per mbledhjen , anetaret e Keshillit Mbikqyres mund te emeruje njerin prej tyre si kryetar te mbledhjes.

Ceshtjet e rendit te dites vendosen me shumicen e votave te pjeseemarrsesve. Ne rast numri te barabarte votash, vota e kryetarit do te jete vendimtare.

Te gjitha aktet e kryera nga Mbledhja e Keshillit Mbikqyres ose komitetet e anetareve te Keshillit Mbikqyres ose nga persona te cilet veprojne si anetar te Keshillit Mbikqyres pavaresisht nese behet e ditur ne vijim se emerimi i anetarit te Keshillit Mbikqyres ka pasur mangesi ose keta anetare jane skualifikuar nga mbjatja e kesaj detyre ,ose nuk kishin te drejte te votonin, do te konsiderohen te vlefshme njelloj sikur keto persona te ishin emeruar rregullisht dhe te ishin cilesuar dhe te vazhdonin detyren si anetar te Keshillit Mbikqyres dhe te kishin te drejte te votonin ne Mbledhje.



Vendimi me shkrim i nenshkruar nga te gjithë anetaret e keshillit Mbikqyres te cilet kane te drejte te njoftohen per mbledhjet e Keshillit Mbikqyres ose te nje komiteti te Keshillit Mbikqyres eshte njelloj i vlefshem dhe i efektshem sikur te ishin miratuar ne mbledhjen e Keshillit Mbikqyres ose te komitetit te Keshillit Mbikqyres, te mbledhur per tu zhvilluar rregullisht.

Neni 25

Kufizime per votimin e anetareve te Keshillit Mbikqyres

Anetaret e Keshillit Mbikqyres nuk do te lidhin marreveshje ose te votojne ne mbledhejn e Keshillit Mbikqyres ose te Komitetit te Keshillit Mbikqyres mbi ceshtje per te cilat keta anetare kane direct ose indirect nje interes apo detyrim i cili eshte material, qe eshte ose qe mund te jete ne kundërshtim me interesat e shoqerise, ne pajtim me nenin 13 te Ligjit deri ne momentin kur ne mbledhjen e Keshillit Mbikqyres te gjithë anetaret kane rene dakort qe:

-te autorizojne lidhjen e kesaj kontrate

-te autorizojne kete kryetar qe te votoje ne lidhje me kete ceshtje

Autorizimi mund te jete i pergjithshem ose i posacem per nje ceshtje te caktuar. Zbatohet parashikimi i pikave 2 dhe 5 te nenit 13 te Ligjit.

Vota e anetarit te Keshillit Mbikqyres nuk do te llogaritet ne kuorumin e pjesemarrësve ne mbledhje ne lidhje me vendimin per te cilen ky anetar nuk gezon te drejten e votes.

Ne rast se ne mbledhjen e Keshillit Mbikqyres diskutohet nje ceshtje e lidhur me te drejten e votes se nje anetari te tij , ceshtja mund ti drejtohet kryetarit te mbledhjes dhe vendimi i tij lidhur me cdo anetar te Keshillit Mbikqyres te ndryshem nga ai vete do te jete perfundimtar.

Neni 26

Procesverbalet e Keshillit Mbikqyres

Keshilli Mbikqyres eshte pergjegjes per mbajtje ne libra te posacem te procesverbaleve:

1-te gjithë takimet e Keshillit Mbikqyres

2-te gjitha mbledhjet e Keshillit Mbikqyres dhe komiteteve te tij, perfshire edhe emrat e administratoreve te pranishem ne cdo mbledhje.

Neni 27

Shperblimi I punes dhe shpenzimet e Administratoreve dhe te anetareve te keshillit Mbikqyres

Administratori dhe anetaret e Keshillit Mbikqyres shperblehen ne baze te skemes se vendosur nga Keshilli Mbikqyres me vendim te zakonshem te Asamblese se Pergjithshme ne perputhje me parashikimet e pikes 1 neni 160 I Ligjit.

Me miratimin e Asamblese se Pergjithshme, Keshilli Mbikqyres mund te shperndaje shperblime ne para ,pensione ,sigurime ose forma te tjera per administratoret ose anetaret e Keshillit Mbikqyres te cilet kane pasur detyra dhe kane punuar me pare per Shoqerine.

Neni 28

Hetimet e posacme dhe mbikqyrja

Cdo person ose personat qe plotesojne kushtet per te kerkuar emerimin ose zevendesimin e nje eksperti te posacem ne baze te nenit 150 te ligjit ose per te kerkuar nga Keshilli Mbikqyres qe te beje detyrat e tij ne rastet e vecanta te parashikuara nga pika 2 e nenit 166 dhe neni 165 i ligjit depoziton ne seline e Shoqerise dokumentin e noterizuar i cili verteton se ky person ploteson kushtet per te kryer kete veprim.

KREU VI

Neni 29

Dividentet

Ne perputhje me dispozitat e Ligjit , Shoqeria me shumice te zakonshme te votave te Asamblese se Pergjithshme mund te deklaroje devidentet ne perputhje me te drejtat perkatese te aksionareve. Me perjashtim te rasteve kur parashikohet ndryshe nga te drejtat qe lidhen me aksionet te gjithë devidentet deklarohen dhe paguhen ne perputhje me shumat e paguara per aksionet per te cilat paguhet dividenti.

Te gjithë dividendet pjestohen dhe paguhen ne perpjestim te drejte me shumat e paguara per aksionet ,pse se ose pjeseve te periudhes per te cilen paguhet dividenti, ne rast se aksioni emetohet me kushtin e perfitimit te devidentit nga nje date e caktuar devidenti do te paguhet ne perputhje me kete kusht.

Asnje dividend ose pagese ne para qe lidhet me nje aksion nuk prodhon interes kundrejt shoqerise nese nje gje e tille nuk parashikohet net e drejtat e aksionit.

Cdo dividend qe nuk eshte kerkuar te paguhet brenda dymbedhjete vjeteve nga data e maturimit , ne rast se vendoset nga Asambleja e pergjithshme do te perfitohet nga Shoqeria e cila nuk do te jete me e detyruar qe te paguaje ate.

Neni 30

Kalimi i fitimeve ne kapitalin themeltar

Administratori pas vendimit te marre nga asambleja e Pergjithshme me shumice te kualifikuar votash sipas kuorumit te percaktuar nga neni 145 i Ligjit ,mun te vendose te kaloje ne kapitalin themeltar te Shoqerise fitimet e pashperndara te cilat nuk do te perdoren per te paguar dividente preferenciale apo shume te tjera te parashikuara per rezerva ligjore ose kapitali.

KREU VII

Neni 31

Prishja dhe likuidimi

Ne rast te likuidimit te Shoqerise Likuiduesi ne perputhje me Ligjin dhe me vendimin e posacem te Asamblese se Pergjithshme te marre ma shumice te kualifikuar ,mund te shperndaje ne dobi te aksionareve te saj te gjithë ose nje pjese te vleres se pasurise te shoqerise dhe per kete qellim



mund te vleresoje cdo pasuri dhe te percaktoje menyren e shperndarjes midis aksionareve ose atyre qe zoterojen aksione te klasave te ndryshme te Shoqerise,

Neni 32

Njoftimet

Njoftimet e kryera nga cdo person sipas parashikimeve te Statutit duhet te jene me shkrim ose nepermjet komunikimit elektronik ne adresen e parashikur ne piken 3 te nenit 4 te ketij Statuti jane te vlefshme ne lidhje me kohen njoftuar per kete qellim dhe personin qe kryhen njoftimin. Shoqeria mund ti jape njoftimin aksionarit personalisht ose duke derguar me leter porosi kthim pergjigje ne adresen e regjistruar te aksionarit ose ne adresen ose posten elektronike e cila i eshte njoftuar Shoqerise nga aksionari. Ky statut se bashku me ndryshimet, dokumentet,raportet,komunikimet dhe procesverbalet e dhena nga Shoqeria do te publikohen nga Administratori ne faqen e internetit te Shoqerise.

AKSIONARI THEMELUES

Altin Xhari



Date 20.02.2023